

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6679
E hënë, 15 gusht 2022
çmimi 0.40

Presidenti i Shqipërisë viziton sot Kosovën, takon pozitën dhe opozitën | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4-5

QEVERIA KURTI, MË E DOBËTA QË NGA SHPALLJA E PAVARËSISË



- Përpos zhgënjimit, qeveria nuk ka ofruar rezultate për të cilat kanë shpresuar qytetarët

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, ka vlerësuar se qeveria Kurti është më e dobëta që nga shpallja e pavarësisë. Lekaj në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se qeveria ka dështuar në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe sektorin e energjisë. "Këta nuk dinë të qeverisin. Kjo dëshkohet edhe nga rezultatet e

arritura. Edhe sipas statistikave, qeveria Kurti është më e dobëta që nga periudha pas shpalljes së pavarësisë së vendit", ka thënë Lekaj, duke shtuar se kryeministri Kurti ka ndryshuar pothuajse të gjitha qëndrimet. Ndërsa sa iu përket deklaratave të kryeministrit për rrezikun për luftë, Lekaj i ka cilësuar të pamatura dhe absurde

BE-ja PËR TAKIMIN KURTI - VUÇIQ: KOSOVA DHE SERBIA T'I SHMANGIN RETORIKAT NXITËSE



MINISTRIA E JASHTME PLANIFIKON RRRITJEN E NUMRIT TË ATASHEVE USHTARAKË

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE




ÇITAKU: KURTI TË MOS SHKOJË TË DIALOGOJË PËR BARRIKADA ME VUÇIQIN F.3

HOTI: SITUATA E PASIGURISË ËSHTË REZULTAT I MOSVEPRIMIT TË QEVERISË F.3

SOT NIS SEMINARI I GJUHËS SHQIPE, MBI 100 SEMINARISTË PJESËMARRËS F.6

PARALAJMËROHET NGRITJE E ÇMIMIT TË BILETËS NË TRAFIKUN URBAN F.6

EKONOMI



KRIZË E MADHE PËR PUNËTORË NË KOSOVË, BIZNESET PO PUNËSOJNË EDHE PENSIONISTË F.7

MURATI: JANË RRRITUR SHPENZIMET PËR INVESTIMET KAPITALE F.7

RAMA: ËSHTË DYFISHUAR NUMRI I TURISTËVE FRANCEZË NË SHQIPËRI F.7

SPORT

LLAPI, PRISHTINA DHE GJILANI E NISIN ME FITORE F.9

Macroni nënkruan protokollin për anëtarësimin e Suedisë dhe Finlandës në NATO

14 GUSHT - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka nënkruar protokollin e ratifikimit për anëtarësimin e Suedisë dhe Finlandës në NATO, ka njoftuar pallati Elysee. "Kjo zgjedhje sovraane e Finlandës dhe Suedisë, dy partnerë evropianë, do ta përforcojë sigurinë e tyre përballë një kërcënimi në fqinjësinë e tyre të afërt dhe

do të sjellë një kontribut të rëndësishëm në lidhje me kapacitetet e këtyre dy partnerëve", citohet të këtë thënë Macroni.

Më herët, Asambleja Kombëtare e Francës e kishte miratuar pranimin e dy vendeve nordike në aleancën e mbrojtjes. Suedia dhe Finlanda kanë qenë partnere të NATO-s për një kohë të

gjatë, por qëndruan larg anëtarësimit të plotë për dekada. Pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt, Suedia dhe Finlanda kanë ndryshuar kurs. Përpara se protokollin e anëtarësimit të hyjnë në fuqi, ato duhet të ratifikohen nga të 30 vendet anëtare të NATO-s. Gjermania dhe shumë shtete të tjera kanë dhënë tashmë miratimin e tyre.



Ukraina kërkon sanksione ndaj industrisë bërthamore ruse



KIEV, 14 GUSHT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka bërë thirrje Perëndimit të vendosë sanksione kundër industrisë bërthamore të Rusisë në vazhden e luftimeve për termocentralin bërthamor të Zaporizhyas.

"Rusia po përdor termocentralin bërthamor në Ukrainën Jugore për t'i frikësuar njerëzit dhe për ta shantazhuar udhëheqjen ukrainase dhe të gjithë botën", ka thënë Zelensky. Rusia, një fuqi bërthamore për

sa i përket armatimit, është duke ndërtuar termocentrale bërthamore në disa vende.

Kievi dhe Moska e kanë akuzuar njëri-tjetrin prej ditësh se janë përgjegjës për bombardimin e termocentralit më të madh bërthamor në Evropë.

Zelensky i ka akuzuar trupat ruse për përdorimin e zonës së pushtuar nga Rusia si një fortesë nga e cila do të sulmonte më pas mbi qytetet e vogla Nikopol dhe Marhanez, që shtrihen në bregun tjetër të Dnipro.

Ai ka paralajmëruar se vendosja e trupave ruse në vendin e termocentralit bërthamor rrit kërcënimin radioaktiv për Evropën në një nivel që nuk ekzistonte as në momentet më të vështira të konfrontimit në kohën e Luftës së Ftohtë.

Zelensky ka bërë thirrje për një reagim të ashpër. Ukraina u ka bërë thirrje shteteve perëndimore edhe për ndihmë për t'i ndjekur penalisht krimet ruse të luftës të kryera gjatë pushtimit të vendit.

BE-ja: Talibanët kanë dështuar të krijojnë sistem politik gjithëpërfshirës

BRUKSEL, 14 GUSHT - Bashkimi Evropian i ka akuzuar talibanët se "kanë dështuar të krijojnë një sistem politik gjithëpërfshirës" në prag të përvjetorit të parë të sundimit të lëvizjes islamike. "Popullsia, duke përfshirë grupet etnike dhe fetare, në veçanti popullatën Shiite, po përjeton abuzim të institucionalizuar dhe sistematik të të drejtave të tyre ekonomike, sociale, kulturore, civile dhe politike. Më konkretisht, ata kanë shkelur dhe abuzuar rëndë të drejtat e grave dhe vajzave afgane, të cilat mbeten të privuara nga arsimit mesëm, ndërsa kufizimet e reja në kodet e veshjes dhe lëvizjes i kanë përjashtuar ato nga shumica e aspekteve të jetës ekonomike

dhe publike", ka thënë Nabila Massrali, zëdhënëse e BE-së për çështjet e Jashtme.

Në deklaratë është thënë se nuk ka mekanizëm që mbron gratë dhe vajzat dhe se dhuna në familje është rritur. "Mekanizmat për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna dhe martesat e detyruara janë çmontuar dhe dhuna në familje është në rritje", ka thënë ajo.

Talibanët kanë pushtuar Kabul më 15 gusht 2021, duke u rikthyer në pushtet në Afganistan gati 20 vjet pasi ata ishin rrëzuar nga pushtimi i ShBA-së pas sulmeve të 11 shtatorit 2001.

Asnjë vend nuk e ka njohur ende sundimin e talibanëve pasi fillimisht ata kanë deklaruar se



do të ishin më të moderuar se në kohën e tyre të mëparshme. Talibanët janë kthyer në një linjë më të ashpër, duke shtypur të drejtat e grave, duke lejuar pak kritika dhe duke vendosur kontroll më të madh mbi median.

Vërejtja e BE-së vjen një ditë pasi një protestë e grave në Kabul është shpërndarë me dhunë nga

luftëtarët talibanë, të cilët kanë qëlluar me armë në ajër dhe kanë rrahur protestuesit që kishin kërkuar "bukë, punë dhe liri".

Rreth 40 gra kanë marshuar para ndërtesës së Ministrisë së Arsimit më 13 gusht përpara se luftëtarët t'i shpërndanin. Fotot dhe videot e protestës të postuara në rrjetet sociale dhe medie kanë treguar se

forcat talibane kanë sulmuar fizikisht gratë. Disa gra janë ndjekur nga luftëtarët talibanë, të cilët i kanë qëlluar ato me kondakët e pushkëve.

Talibanët, gjithashtu, kanë arrestuar tre gazetarë të huaj dhe një punëtor afgan për mbulimin e protestës, ndërsa dy gazetarë të tjerë vendas janë plagosur lehtë, sipas Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur Afganistanë (AIJA).

Hujatullah Mujadidi, anëtar i lartë i AIJA-s me bazë në Kabul, ka thënë se gazetarët e huaj të arrestuar ishin nga Gjermania, Danimarka dhe Norvegjia. Amnesty International ka shprehur shqetësimin për raportimet se talibanët përdorën "forcë të tepruar" për t'i shpërndarë gratë.

I përmirësohet gjendja Salman Rushdies, i hiqet oksigjeni

NJU-JORK, 14 GUSHT - Salman Rushdie është hequr nga oksigjeni dhe është në gjendje të flasë pasi ka pësuar lëndime të rënda nga një sulm me thikë. Agjenti i tij, Andrew Wylie, e ka konfirmuar informacionin më 13 gusht për mediet amerikane, por nuk ka dhënë detaje të tjera.

Rushdie, shkrimtar me origjinë indiane, i cili para disa vjetësh ishte urdhëruar të vritej nga Irani për shkak të shkrimeve të tij, është sulmuar më 12 gusht derisa ishte në skenë në një seminar në Nju-Jork.

Sulmuesi Hadi Matar, 24-vjeçar nga Nju-Xhersi, është deklaruar i pafajshëm. Ndaj tij

është ngritur akuzë për tentimvrasje dhe tentimsulm. Pas sulmit me thikë Rushdie është shtruar në spital, pasi i janë dëmtuar nervat dhe mëlcia.

Agjenti i Rushdies bëri me dije një ditë më parë se shkrimtari i është nënshtruar një operacioni dhe se ai ka gjasa ta

humbë njërin sy.

Rushdie, i cili ka lindur në një familje myslimane indiane, është përballur me kërcënime me vdekje për romanin e tij të katërt "Vargjet satanike", për të cilin disa myslimanë kanë thënë se përmban pasazhe blasfemuese. Romani është ndaluar në shumë vende me



popullsi të madhe myslimane pas botimit të tij në vitin 1988.

Haradinaj: Kurti mashtrues, po dëshiron marrëveshje për mossulmim me Serbinë



PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka folur për takimin në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, që pritet të mbahet më 18 gusht në Bruksel. Haradinaj e ka quajtur Kurtin

mashtues, duke thënë se po dëshiron marrëveshje “për mossulmim me Serbinë”, nën një emër si marrëveshje e marrëdhënieve të mira, e që është kthim prapa. “Ne kemi interes për marrëveshje finale për njohje reciproke Kosovë - Serbi. Mashtuesi po do

marrëveshje për mossulmim me Serbinë, nën një emër si marrëveshje e marrëdhënieve të mira, e që është kthim prapa. Siguria e plotë për Kosovën arrihet duke e shpejtuar anëtarësimin në NATO”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”

Presidenti i Shqipërisë viziton sot Kosovën, takon pozitën dhe opozitën

PRISHTINË, 14 GUSHT - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, sot (e hënë) do ta vizitojë Kosovën, që shënon edhe vizitën e tij të parë zyrtare në vendin tonë.

Takimin e parë Begaj do ta bëjë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila do ta presë homologun e saj me ceremonitë më të larta shtetërore, duke filluar nga ora 10:00.

Takimin e dytë Begaj do ta zhvillojë me kryeparlamentarin Glauk Konjufca nga ora 12:15, ndërsa në orën 13:00 do të fillojë takimi i Begajt me kryeministrin Albin Kurti.

Presidenti shqiptar do të zhvillojë takime edhe me

kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku si dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Po ashtu, presidenti Begaj do të takohet edhe me trupat e Forcave të Armatosura Shqiptare që shërbejnë në KFOR, pastaj do të takohet edhe kryetarin e Prizrenit dhe do ta vizitojë Kompleksin e Lidhjes së Prizrenit.

Begaj vizitën në Kosovë do ta shfrytëzojë edhe për të bërë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te kompleksi memorial “Adem Jashari” në Prekaz, si dhe do të bëjë vizitë edhe në shtëpinë muze të familjes Jashari.



Çitaku: Kurti të mos shkojë të dialogojë për barrikada me Vuçiqin

PRISHTINË, 14 GUSHT - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se procesi i dialogut Kosovë - Serbi rrezikon të kthehet në dialog teknik dhe, si i tillë, fajin kryesor duhet ta bartë Serbia, në asnjë mënyrë Kosova. Duke folur për takimin që do ta ketë Kurti në Bruksel, ish-diplomatja e Kosovës thotë se qeveria duhet të bisedojë për marrëveshjen finale me njohje reciproke, assesi për “barrikada dhe stikersa”.

Çitaku ka thënë se presidenti serb dëshiron të qëndrojë gjendja aktuale në Ballkan dhe në dialogun në mes të Kosovës dhe të Serbisë. “Unë pres që kryeministri të mos shkojë në



Bruksel për të negociuar për barrikadat dhe për stikersat. Unë pres që kryeministri të shkojë në Bruksel dhe të flasë

për një marrëveshje gjithëpërfshirëse me njohjen reciproke në qendër. Ne nuk bën të pajtohemi për asgjë pa u

pajtuar për çdo gjë. Kryeministri duhet të jetë i vëmendshëm. Ne nuk bën të biem në grackën e Vuçiqit,

sepse atij i konvenon status-quoja, i konvenon prolongimi i procesit dhe që ne të diskutojmë në Bruksel për çështje teknike. Ne duhet ta kemi ofertën tonë, të koordinohemi ngushtë me partnerët tanë sepse nuk është detyra jonë që të përkujdesemi për disponim në Beograd, por që ta bëjmë pjesën tonë të punës, të jemi konsistencë dhe të koordinohemi ngushtë me aleatët tanë”, ka thënë Çitaku. Teksa ka folur për luftën në Ukrainë, Çitaku ka thënë se Kosova nuk ka arritur ta fuqizojë subjektivitetin ndërkombëtar. Ajo ka thënë se në vend të saj, institucionet vazhdojnë të merren me stikersa.

Hoti: Situata e pasigurisë është rezultat i mosveprimit të qeverisë

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se situata depresive dhe e pasigurisë në Kosovë erdhi si rezultat i mosveprimit të qeverisë. Hoti ka thënë se një qeverisje e motivuar për punë do të duhej të ishte komunikuese me parterët

socialë për t'i evituar problemet me të cilat po përballemi dhe jo të jetë e shtyrë nga populizmat. “Situata depresive dhe e pasigurisë në Kosovë është kryesisht rezultat i veprimeve/mosveprimeve të qeverisë ndaj zhvillimeve ekonomike e politike në

Kosovë dhe rajon. Një qeverisje e mbarë dhe normale, e motivuar për punë e jo e shtyrë nga populizmat, komunikuese me partnerët socialë, do t'i kishte evituar problemet me të cilat po përballemi, ose së paku do t'i kishte zbutur pasojat për qytetarët”, ka thënë Hoti.





FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

Qeveria Kurti, më e dobëta që nga shpallja e pavarësisë

- Përpos zhgënjimit, qeveria nuk ka ofruar rezultate për të cilat kanë shpresuar qytetarët

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, ka vlerësuar se qeveria Kurti është më e dobëta që nga shpallja e pavarësisë. Lekaj në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se qeveria ka dështuar në të gjitha fushat, edhe në sektorin e energjisë. "Këta nuk dinë të qeverisin. Kjo dëshmohet edhe nga rezultatet e arritura. Edhe sipas statistikave, qeveria Kurti është më e dobëta që nga periudha pas shpalljes së pavarësisë së vendit", ka thënë Lekaj, duke shtuar se kryeministri Kurti ka ndryshuar pothuajse të gjitha qëndrimet. Ndërsa sa i përket deklaratave të kryeministrit për rrezikun për luftë, Lekaj i ka cilësuar të pamatura dhe absurde

Lirim GECI

PRISHTINË, 14 GUSHT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka thënë se jeta e qytetarëve me qeverinë Kurti është bërë më e vështirë. Lekaj në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës gjendja nuk ka qenë më e keqe. "Qeveria Kurti e mori mbështetjen masive duke proklamuar shpresë për të

rinjtë, vende të reja pune e jetë më të mirë. Që nga marrja e detyrës së kësaj qeverie, po shohim që gjendja ka ndryshuar për të keq në çdo fushë në vend", është shprehur Lekaj, duke shtuar se qeveria Kurti është e paaftë ta zgjidhë krizën energjetike në vend. "Kemi bllokim të buxheteve komunale nga paaftësia apo inati i pushtetit qendror. Kemi rritje të inflacionit prej 14-përqindësh. Pavarësisht prej kërkesës sonë për largim të TVSh-së në produktet bazike,

qeveria ka heshtur. Shohim se gjendja me energji elektrike që prej pavarësisë kurrë nuk ka qenë më e keqe. Kemi reduktime e shtrenjtim të energjisë për qytetarët që paguajnë energjinë, por jo edhe për ata në pjesën veriore. Vetëm para pak ditësh qeveria i ka ndarë 40 milionë për atë pjesë", është shprehur Lekaj. Më tutje, Lekaj në këtë intervistë ka folur edhe për dialogun me Serbinë dhe për deklaratën e kryeministrit Albin Kurti për luftë. Sa i përket

dialogut, Lekaj ka thënë se qeveria Kurti ka qasje të gabuar. "Kurti duhet të insistojë në një dialog ku diskutohet për marrëveshjen finale me njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë nën udhëheqjen e ShBA-së", ka deklaruar Lekaj. Ndërsa deklaratën e Kurtit për rrezikun e një lufte me Serbinë, Lekaj e ka quajtur të pamatur dhe absurde. "Kosova ka institucione kredibile të sigurisë dhe trupat paqeruajtëse të NATO-s, të cilat garantojnë stabilitet dhe ruajnë kufijtë e vendit. Sa i përket deklaratave të kryeministrit për rrezikun për luftë, unë i konsideroj të pamatura dhe absurde", ka thënë Lekaj.

"Epoka e re": Z. Lekaj, si i vlerësoni zhvillimet politike, ekonomike dhe të sigurisë në Kosovë?

Lekaj: Jemi dëshmitarë që në dy vjetët e fundit jeta e qytetarit të Kosovës është bërë më e

vështirë. Kemi rritje enorme të çmimeve të produkteve esenciale, të cilat kanë ndikuar edhe në rritjen e kostos së përgjithshme të produkteve e mos të flasim për zhvillim ekonomik, të cilin vetëm qeveria e sheh dhe e proklamon vazhdimisht, kurse realiteti është që pas pavarësisë kurrë nuk ka qenë gjendja më e keqe sa i përket aspektit ekonomik. Në aspektin politik, qeveria, disi e ndikuar nga fuqia e numrave që ka në Kuvend, është treguar arrogante ndaj opozitës, duke injoruar çdo nismë apo iniciativë që ka qenë në shërbim të qytetarëve, sikurse Ligji i Pagave, tërheqja e 30 përqindëshit të Trustit etj. Pra, pavarësisht që qeveria Kurti ka shumicën në Kuvend, nuk ka treguar ndonjë performancë të kënaqshme, edhe ashtu shumica e vendimeve që kanë qenë interes i përbashkët qytetar janë mbështetur nga AAK-ja

BE-ja për takimin Kurti - Vuçiq: Kosova dhe Serbia t'i shmangin retorikat nxitëse

BRUKSEL, 14 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) ka ftuar liderët politikë në Kosovë dhe Serbi që menjëherë t'i japin fund retorikës nxitëse dhe të veprojnë me përgjegjësi. BE-ja ka shprehur shqetësim për deklaratat në të cilat përmenden lufta dhe konflikti, dhe ka shtuar se "do t'i mbajë përgjegjës liderët politikë për çfarëdo përshkallëzimi të situatës në rajon". Kështu është thënë në deklaratën e 14 gushtit të BE-së, dërguar nga zëdhënësi Peter Stano. "Rritja e retorikës nxitëse kohën e fundit nga ana e zyrtarëve të Kosovës dhe Serbisë, në veçanti deklaratat rreth luftës dhe konfliktit në Ballkanin Perëndimor, paraqesin shqetësim të madh. Politikanët e lartë nga të dyja palët do të mbahen përgjegjës për çfarëdo përshkallëzimi që mund të çojë deri te ndonjë rritje e tensioneve dhe potencialisht në dhunë në rajon", është thënë në këtë deklaratë.

Në këtë deklaratë është thënë se të dyja palët duhet "menjëherë t'u japin fund armiqësisë mes tyre dhe deklaratave nxitëse, si dhe të veprojnë me përgjegjësi". Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", se më 31 korrik pati rrezik për përshkallëzim të situatës në konflikt të armatosur "për shkak



të frikës së injektuar nga Beogradi dhe për shkak të planeve të bëra në Rashkë dhe në Beograd".

Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se ka informacione për plane se në veri të Kosovës po përgatitet "likuidimi i popullit tonë", duke iu referuar popullsisë serbe që jeton në Kosovë. Një ditë pas kësaj deklarate, kryeministri Kurti tha se, kur zyrtarët në Beograd, përfshirë presidentin serb Aleksandër Vuçiq, flasin për dhunë dhe vrasje në Kosovë, ata flasin për vete, "flasin për imagjinatën e mendimet e tyre".

BE-ja ka theksuar se të gjitha çështjet e hapura mes dy vendeve duhet të adresohen

përmes dialogut. "BE-ja pret që dy liderët të diskutojnë këto tema sfiduese në takimin e radhës të nivelit të lartë në kuadër të dialogut, të ftuar nga përfaqësuesi i lartë Josep Borrell", është thënë në deklaratën e zëdhënësit të BE-së.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen në Bruksel më 18 gusht.

Bashkimi Evropian (BE) ka ritheksuar se arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obliguese për normalizimin e plotë të raporteve kërkon një klimë e cila do t'i kontribuonte kthimit të besimit, pajtimit dhe raporteve të mira, "ku marrëveshjet e së

kaluarës respektohen dhe implementohen në tërësi, dhe ku veprimet e deklaratat të cilat nuk janë në përputhje me interesat e përgjithshme dhe qëllimet strategjike të rajonit, nuk kanë vend".

BE-ja ka thënë se bashkë me EULEX-in në Kosovë është në koordinim të afërt me KFOR-in dhe partnerët ndërkombëtarë, në veçanti Shtetet Bashkuara të Amerikës.

Më 17 gusht sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do të mbajë takime të ndara në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin serb Aleksandër Vuçiq.

Një ditë pas, më 18 gusht, do të zhvillohet takimi i dy liderëve

nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Ky takim ishte thirrur pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës.

Më 31 korrik serbët lokalë vendosën barrikada në veri të Kosovës për t'i kundërshtuar dy vendimet e Qeverisë së Kosovës lidhur me targat dhe dokumentet serbe. Barrikatat janë hequr më 1 gusht dhe Qeveria e Kosovës është zotuar se do ta shtyjë për një muaj zbatimin e vendimit për pajisjen e shtetasve të Serbisë me dokument për hyrje-dalje, me të hyrë në territorin e Kosovës. Prej atëherë liderët politikë kanë shkëmbyer akuza të ndërsjella për tensionimin e situatës.

dhe partitë e tjera në Kuvend. Është fakt se kryeministri Kurti ka ndryshuar shumicën e qëndrimeve të tij sa ishte opozitar. Si në dialog me Serbinë, por edhe në çështjet e brendshme. Aspekti i sigurisë është stabil, pavarësisht prej zhvillimeve të fundit në veri. Kosova ka institucione kredibile të sigurisë dhe trupat paqeruajtëse të NATO-s, të cilat garantojnë stabilitet dhe ruajnë kufijtë e vendit. Sa i përket deklaratave të kryeministrit për rrezikun për luftë, i konsideroj të pamatura dhe absurde.

"Epoka e re": Po punën e qeverisë Kurti?

Lekaj: Qeveria Kurti e mori mbështetjen masive duke proklamuar shpresë për të rinjtë, vende të reja pune e jetë më të mirë. Që nga marrja e detyrës së kësaj qeverie po shohim që gjendja ka ndryshuar për të keq në çdo fushë në vend. Kemi bllokim të buxheteve komunale nga paaftësia apo inati i pushtetit qendror. Kemi rritje të inflacionit prej 14-përqindësh. Pavarësisht prej kërkesës sonë për largim të TVSh-së në produktet bazike, qeveria ka

heshtur. Shohim se gjendja me energji elektrike kurrë nuk ka qenë më e keqe që pas shpalljes së pavarësisë. Kemi reduktime dhe shtrenjtim të energjisë për qytetarët që paguajnë energjinë, por jo edhe për ata në pjesën veriore. Vetëm para pak ditësh qeveria i ka ndarë 40 milionë për atë pjesë. Nuk kemi rritje të pagave, nuk ka rritje të mirëqenies, ka vetëm rritje të kërkesës për largim nga vendi, e cila, sipas shifrave zyrtare, po arrin shifra rekorde. Është fakt që kjo qeveri, përpos zhgënjimit, qytetarëve nuk u ka ofruar rezultatet për të cilat ata kanë shpresuar.

"Epoka e re": Kryeministri Kurti më 18 gusht do të takohet me Vuçiqin në Bruksel. Çfarë prisni nga ky takim?

Lekaj: E kemi potencuar shumë herë që Kurti me qasjen e tij ndaj dialogut po rrezikon ta kthejë dialogun tërësisht në dialog për çështje teknike. Konsideroj se vendimi për reciprocitet është i drejtë dhe legjitim. Qeveria as që duhet ta diskutojë këtë çështje në dialog, por vetëm ta zbatojë atë vendim në afatin e paraparë. Kurti duhet të insistojë në një dialog ku

diskutohet për marrëveshjen finale me njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë nën udhëheqjen e ShBA-së.

"Epoka e re": Si e vlerësoni deklaratën e Kurtit për mundësinë e përshkallëzimit të situatës në veri?

Lekaj: Siç theksova, deklaratat për mediet e huaja për rrezikun që i kanoset Kosovës për sulm nga Serbia janë absurde dhe të pakuptimta. Qeveria nuk duhet të ndalet në veprimet e saj për shtrirjen e rendit dhe ligjit në veri. Sigurisht se, krahasuar me vitet e kaluara, gjendja në atë pjesë është dukshëm më e mirë falë edhe qeverive të kaluara. Ndërkohë, veprimet në vazhdim duhet të jenë të matura dhe të analizuar mirë edhe me partnerët tanë.

"Epoka e re": Çfarë zhvillimesh e presin Kosovën në sesionin vjeshtor të punës së Kuvendit?

Lekaj: Sigurisht se ka shumë tema të cilat presin për t'u trajtuar qysh në fillim të sesionit vjeshtor të Kuvendit. Si grup parlamentar i AAK-së do të kërkojmë sjelljen sa më parë të Ligjit për Paga. Me prioritet do ta trajtojmë çështjen e energjisë

elektrike dhe masat për arritjen e një stabiliteti në këtë temë. Çështjet me interes të veçantë do të jenë çështjet që lidhen me mirëqenien ekonomike, dialogun dhe sigurinë.

"Epoka e re": Vazhdimisht opozita ia ka tërhequr vërejtjen pushtetit për krizën energjetike që mund ta përfshijë Kosovën. Sipas jush, a do të mund ta menaxhojë si duhet këtë krizë?

Lekaj: Ne me kohë e patëm paralajmëruar qeverinë për krizën që na pret me energji elektrike. Gabim fatal i kësaj qeverie ishte anulimi i ndërtimit të termocentralit Kosova C. Me të do të siguronim stabilitet energjik. Po shihet që qeveria është e paafte për të ofruar një zgjidhje që sjell stabilitet energjetik dhe qytetarëve u mundëson rrymë pa reduktime dhe pa rritje të çmimit të faturave. Mos të harrojmë pagesën prej 40 milionë eurosh për veri përderisa qytetarëve të pjesës tjetër të Republikës së Kosovës i rritet çmimi i faturave të energjisë.

"Epoka e re": AAK-ja ka kohë që është duke kërkuar miratimin e Ligjit për Pagat, madje e ka

akuzuar qeverinë për mosseriozitet në këtë temë. Sipas jush, pse është duke ndodhur zvarritja e miratimit të këtij ligji?

Lekaj: Ligji për Paga është sjell fillimisht nga qeveria Haradinaj, por më pas, për shkak të ndërhyrjeve në komisionet parlamentare, Gjykata Kushtetuese pati hedhur poshtë disa nene të tij. Grupi parlamentar i AAK-së që nga fillimi i kësaj legjislature ka kërkuar nga qeveria ta sjellë këtë ligj për miratim. Dihet që gjendja financiare për punëtorët e sektorit publik nuk është e mirë. Është e pakuptimtë që ky ligj ende nuk është sjell nga qeveria. Realisht ka dështuar në këtë temë. Po dëshmohet që nuk janë për vendimmarrje të guximshme të cilat janë në të mirë të qytetarëve, por vetëm për prodhim të krizave dhe marrje të vendimeve ad-hoc të cilat po dëshmohet se kanë prodhuar rezultate. Këta nuk dinë të qeverisin. Kjo dëshmohet edhe nga rezultatet e arritura. Edhe sipas statistikave, qeveria Kurti është më e dobëta që nga periodha pas shpalljes së pavarësisë së vendit.

Ministria e Jashtme planifikon rritjen e numrit të atasheve ushtarakë

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kosova aktualisht përfaqësohet me atashe ushtarakë në vetëm shtatë shtete në botë. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës kanë thënë se janë në koordinim me Ministrinë e Mbrojtjes për ta gjetur formën më të mirë të zgjerimit të rrjetit të atasheve të mbrojtjes. Njohës të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë kanë vlerësuar se Kosova duhet të jetë e përfaqësuar me atashe ushtarakë në të gjitha vendet anëtare të NATO-s me të cilat ka marrëveshje bilaterale.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Turqia, Kroacia dhe Shqipëria janë shtetet ku Kosova ka të dërguar atashe të mbrojtjes.

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, ka thënë për "Kosovapress" se janë duke shikuar edhe për rritjen e

numrit të marrëveshjeve SOFA.

"Ne jemi në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes, me ministrin Mehaj dhe kabinetin e tij, që ta shohim formën më të mirë të zgjerimit të këtij rrjeti të atasheve të mbrojtjes, gjithashtu edhe rritjen e numrit të marrëveshjeve SOFA, sepse kjo është e rëndësishme edhe për vetë ngritjen e ushtrisë sonë dhe përgatitjen e saj. Edhe në kuptimin diplomatik ka efekte të mira. Në kuptimin diplomatik ka gjithsesi efekt të mirë. Synimi ynë është përafrimi me NATO-n. Po ashtu, besojmë se do të ndodhë shpejt edhe përfshirja në Programin e Partneritetit për Paqe", ka thënë Ahmeti.

Ndërsa nënkryetari i Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes nga radhët e Vetëvendosjes, deputeti Enver Dugolli, ka thënë se Kosova mund ta aplikojë modelin e



atasheve, të cilët, sipas tij, mund të mbulojnë disa shtete njëkohësisht. "Ekzistojnë praktika të ndryshme në diplomacinë ushtarake. Edhe shtetet që janë goxha të zhvilluara me ekonomi të madhe e të fuqishme e

aplikojnë këtë formë të diplomacisë ushtarake. Jo çdo shtet ka atashe të mbrojtjes. Ato në një shtet kanë atashe rezidentë të mbrojtjes, ndërsa jorezidentët i mbulojnë shtetet përreth, dy-tri shtete. Mendoj se edhe kjo është formë e aplikuar

prej shteteve të tjera dhe ne do të zbatojmë edhe në praktikë me atashe ushtarakë të mbrojtjes, pra që t'i mbulojnë edhe shtetet që nuk kemi atashe rezidentë", ka thënë Dugolli.

Ndërsa deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ariana Musliu-Shoshi, e cila është pjesë e Komisionit për Punë të Jashtme, ka thënë se duhet të ketë atashe ushtarakë në të gjitha qendrat me rëndësi. Më tutje, Xhavit Gashit, atashu i parë ushtarak i Kosovës, ka thënë se numri i këtyre të dërguarve duhet të rritet, por fokusi duhet të jetë cilësia e tyre. Republika e Kosovës ka mbi 60 ambasada dhe konsullata në vende të ndryshme të botës. Kosova është duke synuar përfshirjen në Partneritetin për Paqe, ndërsa krerët e shtetit vazhdimisht deklarojnë se vendi duhet të anëtarësohet sa më parë në NATO.

Sot nis Seminari i Gjuhës Shqipe, mbi 100 seminaristë pjesëmarrës

PRISHTINË, 14 GUSHT - Në dy javët e fundit të gushtit mbi 100 seminaristë nga e gjithë bota do të marrin pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Këtë vit shënohet edicioni i 40 i seminarit, në të cilin do të mbahen ligjërata nga albanologë të huaj e vendorë. Edicioni i sivjetmë do të nisë sot (e hënë) dhe do të përfundojë më 26 gusht.

Drejtori i seminarit, Shkumbin Munishi, ka thënë se nga viti 1974, kur ka nisur të organizohet seminari, është arritur që Prishtina dhe Kosova të shndërrohen në qendër të albanologjisë. "Edicioni i sivjetmë i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është edicioni jubilar i 40. Pra, janë dyzet edicione të seminarit që janë mbajtur dhe që do të mbahet sivjet. Është

një edicion jubilar dhe në këtë kuptim është një tregues i një tradite tashmë të vendosur të seminarit. Si një prej ngjarjeve më të rëndësishme në fushën e studimeve të albanologjisë, por edhe të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Meqë është edicioni jubilar, sivjet kemi bërë përpjekje që të ftojme personalitete të ndryshme, albanologë nga vende të ndryshme të botës të cilët do të jenë pjesëmarrës në edicionin e sivjetmë", ka thënë ai.

Akomodimi i seminaristëve do të bëhet në konviktet e Qendrës Studentore të Universitetit të Prishtinës. Përveç ligjëratave të albanologëve të shquar, do të mbahen dy herë në ditë edhe kurse të gjuhës.

Më tutje, Munishi ka theksuar se këtë vit do të shënohet numër rekord i pjesëmarrësve, ndërkohë që seminari organizohet tash e 48 vjet.



"Sivjet kemi një interesim jashtëzakonisht të madh. Do të kemi një numër shumë të madh të seminaristëve, i cili këtë vit do ta kalojë numrin 100. Kemi më tepër se 100 seminaristë që do të vijnë nga vende të ndryshme. Përveç tyre, do të kemi edhe albanologë të huajë dhe vendas që do të marrin pjesë në aktivitetet shkencore të seminarit. Pjesëmarrja në këtë edicion të seminarit është

shumë e madhe. Do të kemi seminaristë që do të vijnë nga vende të ndryshme të botës, nga qendrat albanologjike që janë në Poloni, Bullgari, pastaj do të vijnë mysafirë nga Turqia, Holanda, nga Gjermania. Sivjet do të kemi një numër të konsiderueshëm nga Italia, Serbia dhe Maqedonia", ka thënë ai për "Kosovapress". Seminari i Gjuhës Shqipe tashmë është bërë një qendër e studimeve albanologjike, për

çfarë Munishi ka treguar se në dy javët e fundit të gushtit do të ketë gjallëri në kryeqytet. "Është një edicion jubilar dhe ne kemi ftuar albanologë prominentë që të jenë pjesëmarrës në seminar. Këtë vit do të kemi disa ligjërata shumë të rëndësishme të albanologëve të shquar të huaj dhe shqiptarë. Këtë vit do ta kemi mysafirë albanologë e nderuar Irena Sawicka, Artur Karashinski, Ekaterina Tompomanova, Eda Derhemi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bardhyl Demiraj dhe natyrisht do të kemi ligjërata nga albanologë të shquar vendas", ka treguar Munishi. Hapja e edicionit të 40 të këtij seminarit do të bëhet në orën 11:00 në Bibliotekën Universitare. Ky seminar, i cili është themeluar në vitin 1974, organizohet për studentët dhe studiuesit e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, por edhe për albanologjinë në përgjithësi.

Paralajmërohet ngritje e çmimit të biletës në Trafikun Urban

PRISHTINË, 14 GUSHT - Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, Ilirik Musliu, ka treguar se në kryeqytet parashihet të operojnë 161 autobus.

Ndërmarrja "Trafiku Urban" operon me 51 autobus dhe pritet t'i shtohen edhe 30 të tjerë. Musliu ka thënë se me blerjen e autobusëve të rinj do

të ngrihet edhe çmimi i biletave nga 40 në 50 centë. Sipas tij, kërkesë tjetër është edhe operimi i minibusëve për zonat rurale dhe urbane. Ai ka sqaruar se sektori privat do të operojë me 80 autobus të rinj.

"Me planin e mobilitetit për kryeqytetin parashihet të operojnë 161 autobus. Realisht me këta autobus do t'i bëjmë

zgjidhje transportit publik. Ne për momentin kemi 51 autobus në Trafikun Urban. Do të vijnë edhe 30 të tjerë. Prej BERZh-it kemi disa kushte para se ta bëjmë thirrjen e re për blerjen e autobusëve të rinj. Kushti i parë ka të bëjë me nënshkrimin e kontratës me njërin prej operatorëve privat. Kushti i dytë është rritja e

çmimit të biletës prej 40 centësh në 50 centë, për arsye se çmimi i derivateve ka qenë krejt tjetër. Po shohim arsye të qëndrueshme për ngritje të çmimit. Prej 30 autobusëve, 6 ose 8 do të jenë elektrikë. Së fundmi kemi kërkesë edhe për minibus për disa zona rurale. Minibusët mund të përdoren



edhe brenda qendrës në kryeqytet. Pjesa e sektorit privat mendohet të operohet me 80 autobus të rinj", ka thënë ai në një intervistë për "Ekonomia Online".

Krizë e madhe për punëtorë në Kosovë, bizneset po punësojnë edhe pensionistë

PRISHTINË, 14 GUSHT - Mbi 90 për qind të punëtorëve të moshës 20 deri 40-vjeçare janë duke u larguar nga Kosova për shkak të kushteve dhe pagës së ulët që ofrohet në vend. Në mungesë të tyre, kompanitë janë duke u detyruar të punësojnë edhe pensionistë.

Mungesa e punëtorëve ka nisur të vërehet pothuajse në të gjithë sektorët, pasi që të rinjtë çdo ditë po migrojnë drejt vendeve evropiane, por gjatë sezonit të verës edhe po punojnë në vendet bregdetare.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve në Sektorin Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka thënë se ka shumë arsye të largimit të punëtorëve nga Kosova. "Realisht kemi shumë arsye. Arsyeja e parë është sepse më shumë se 20 vjet kanë shkuar dhe gjendja e punëtorëve të këtij sektori nuk është përmirësuar. Së këndejmi, punëtorët e kualifikuar kanë gjetur rrugën e vet në një formë, nuk kanë shkuar, por ne ua kemi imponuar të shkojnë, pasi nuk ua kemi dhënë hakun ashtu siç duhet. Me një pagë të cilën e kanë marrë këtu, edhe këta punëtorët e kualifikuar, përpos çështjeve elementare të të



ushqyerit, nuk kanë mundur të bëjnë asgjë", ka thënë ai.

Azemi ka thënë se në mungesë të punëtorëve të rinj, po punësohen të pensionuarit. "Ne kemi shumë vende të punës. Në mungesë të tyre po kemi punëtorë të pensionuar që po hyjnë në punë. 90 për qind e punëtorëve të moshës 20 deri në 40 vjeçe kanë synim ikjen jashtë vendit, pasi nuk u kemi krijuar kushte adekuatë. Të rinjtë kanë marrë mësim nga generatat e vjetra sepse ata që kanë punuar me dekada e në fund nuk kanë mundur të krijojnë një mision të mirë social, por edhe nga vizioni që po shihet nuk ka ndonjë perspektivë këtu. Perspektiva e

vetme e tyre është ikja nga jashtë. Për katër muaj kemi pasur mbi 200 mijë aplikime për jashtë", ka thënë Azemi. Sipas tij, sindikata që drejton ka marrë të gjitha veprimet të cilat janë edhe të argumentuara dhe ua ka tërhequr vërejtjen pronarëve të kompanive që të krijojnë kushte më të mira për punëtorët e sektorit privat. Edhe gastronomia edhe spitalet private, ani pse tash e disa muaj kanë hapur konkurse, janë duke hasur në vështirësi të gjetjes së punëtorëve.

Arian Vranica nga Shoqata e Gastronomëve ka thënë për "Kosovapress" se para dhe pas pandemisë punëtorët po vazhdojnë të kenë probleme me

kontratat e punës, paga të vogla dhe duke mos iu paguar kontributet nga punëmarrësit. Kjo ka bërë që të rinjtë të kërkojnë punë jashtë vendit, gjë e cila është trend në rritje edhe këtë vit. Vranica ka theksuar se problem tjetër për sektorin privat është edhe sezoni veror, meqë shumica e të rinjve po kërkojnë punë në bregdetin shqiptar dhe në vendet evropiane. "Çdo vit e më shumë po paraqitet një rritje e interesimit të punëtorëve të sektorit privat të Kosovës në përgjithësi, por edhe të gastronomisë në veçanti, që të emigrojnë drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Ky problem po paraqitet në Kosovë, sidomos në pjesën e dytë të vitit, prej qershorit e tutje, ka rritje të diasporës në Kosovë, por këtu po kërcënohemi edhe nga vendet bregdetare, të cilat kanë një turizëm më të shtuar sesa në Kosovë. Kjo është një problematikë tjetër e cila po ua vështirëson punën bizneseve dhe punëtorëve", ka thënë Vranica.

Ndërsa Vlora Shoshi, menaxhere e një spitali privat për terapi fizikale dhe rehabilitim, në një përgjigje

elektronike për "Kosovapress", ka thënë se tash e disa muaj kanë hapur konkurs për mjekë, infermierë dhe terapeutë, por që numri i të interesuarve është i vogël.

"Në përgjithësi kemi vështirësi të vogla në sektorin shëndetësor, për mjekë, infermierë dhe terapeutë. Problemet lidhen edhe me pandeminë që për dy vjet profesionistët shëndetësorë nuk kanë pasur mundësi ta përfundojnë praktikën dhe procedurat e licencimit. Tash pas lirimit të masave, këtë vit ka filluar të rritet numri i të licencuarve dhe i stafit shëndetësor, por është një rritje e vogël në krahasim me kërkesat në treg. Sa iu përket kushteve të punës, ne i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara për punëtorë, ndërsa sa i përket pagës, punëtorët paguhet 10-20% më shumë se në sektorin publik dhe atij të përgjithshëm në tregun e Republikës së Kosovës", ka thënë Shoshi.

Mungesën e infermierëve dhe mjekëve në Kosovë e kanë potencuar edhe sindikatat joqeveritare me organizim të protestave, duke kërkuar nga qeveria të krijohen kushte më të mira për këtë sektor.

Murati: Janë rritur shpenzimet për investimet kapitale

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka reaguar pas deklaratave të përfaqësuesve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke thënë se pagesat nga buxheti i shtetit për periudhën e parë gjashtëmujore të këtij viti janë 1 miliard e 38 milionë euro.

Murati ka shkruar në "Facebook" se me taksat që mbledh dhe rishpërndan, shteti është një kontribuues i rëndësishëm në ekonominë e vendit. "Pagesat që shteti bën, qoftë në formë të pagave, pensione, mallrave që blen, apo edhe investimeve kapitale, që të gjitha kontribuojnë në

ekonominë e vendit. Ditët e fundit nga opozita dhe nga disa medie kemi parë një fushatë agresive e cila pretendon se qeveria ka bllokuar ekonominë, sepse nuk po shpenzon, mirëpo të dhënat nga po ai raport të cilit i referohet opozita tregojnë të kundërtën. Nga grafiku mund të shihet se periudha gjashtëmujore e parë e vitit 2022 për sa i përket shpenzimit është më e lartë se të gjitha vitet paraprake, madje edhe më e lartë se në vitin 2021, kur kishte edhe zgjedhje. Pra, argumenti se qeveria nuk po e mbështet ekonominë e vendit nuk qëndron aspak sepse, siç edhe mund të shihet nga grafiku,



shpenzimet dhe pagesat nga buxheti i shtetit janë më të lartat ndonjëherë", ka shkruar

Murati. Ndërsa sipas LDK-së katër ministri në qeverinë Kurti në

gjashtë muajt e parë të vitit 2022 nuk kanë shënuar asnjë investim kapital.

LDK-ja ka theksuar se sipas Raportit Financiar të Thesarit investimet kapitale në periudhën gjashtëmujore kanë qenë vetëm 9 për qind apo më të ulëta në dhjetë vjetët e fundit. "Ky raport shpërfaq me fakte dhe numra paaftësinë qeverisëse të pushtetit, ndërsa mosefikasiteti i qeverisë për realizimin e projekteve kapitale po përkthehet me rënie ekonomike, mbyllje biznesesh, humbje të vendeve të punës, rritje të varfërisë si dhe dëmtim zinxhiror në të gjitha fushat e kapluara nga kriza", kanë thënë nga LDK-ja.

Rama: Është dyfishuar numri i turistëve francezë në Shqipëri

TIRANË, 14 GUSHT (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se numri i turistëve francezë është dyfishuar gjatë periudhës janar-korrik krahasuar me një vit më parë. Sipas tij, në vitin 2022 Shqipëria është vizituar nga 38 915 turistë francezë, ndërsa një vit më parë në Shqipëri kanë hyrë 19 184

francezë. "38 915 turistë francezë e kanë vizituar Shqipërinë nga janari në korrik, dyfish më shumë se në vitin e kaluar, 19 184. I vërtetë, plot histori, ngjyra, mbi të gjitha informues dhe frymëzues është ky reportazh i Laurence Delpoux për lexuesit francezë. Përmes bashkëbisedimeve me aktorë

të turizmit shqiptar, janë të shumta vendet dhe më të shumta arsyet të cilat renditen si domosdoshmëri për t'u vizituar, nga plazhet e jugut deri te Përmeti dhe Gjirokastra", ka shkruar Rama në "Facebook". Bashkangjitur postimit të tij, Rama ka publikuar edhe një artikull të gazetës franceze "Femina" për Shqipërinë.



Aty ku shkenca takohet me trillimet: Historia e errët e eugjenikës

Nga Adam RUTHERFORD

Është një veçori e historisë që themelet e biologjisë moderne – dhe për pasojë, disa nga mizoritë më të këqija të shekullit XX – duhet të mbështeten kaq shumë tek bizelet. Kujtoni pak biologjinë që keni mësuar në shkollë dhe Gregor Mendelin, që këtë muaj kremton 200-vjetorin e lindjes.

Edhe pse Mendeli ishte një prift, trashëgimia e tij kryesore nuk ka të bëjë me teologjinë Augustiniane, por me shkencën kryesore të gjenetikës. Në mesin e shekullit XIX, Mendelikultivoi më shumë se 28.000 bimë bizelesh, të cilat kryqëzoheshin me lule vjollce apo lloje të tjera lulesh.

Ajo që zbuloi në atë pyll me bimë bizeleje, ishte se këto tipare trashëgoreshin tek pasardhësit në raporte të parashikueshme. Mendeli kishte zbuluar rregullat e trashëgimisë. Karakteristikat trashëgoreshin në disa njësi diskrete – ato që tani i quajmë gjene – dhe mënyra se si këto njësi kalonin nga një brez në tjetrin ndiqnin modele matematikore të rregullta.

Këto rregulla mësohen në çdo shkollë të mesme, si një pjesë thelbësore e mënyrës sesi ne e kuptojmë biologjinë themelore, gjenet, ADN-në dhe evolucionin. Vepra e Mendelit, e botuar në vitin 1866, u shfaq në të njëjtën kohë kur Darvini po hartonte Teorinë e Evolucionit. Por ky klerik gjenial u injorua në fillim, vetëm për t'u ri zbuluar në fillimin e shekullit të ri, që e cili zgjidhi enigmën e evolucionin darvinian me gjenetikën mendeliane, duke shënuar lindjen e epokës moderne të biologjisë.

Por është një histori më pak të njohur, ajo që e diktoi rrjedhën e shekullit XX-të në një mënyrë tjetër. Origjina e gjenetikës është e lidhur pazgjidhshmërisht me eugjenikën. Duke qenë se Platoni sugjeroi çiftimin e prindërve “të cilësisë së lartë”, dhe Plutarku fliste për vrasjen e foshnjave spartane me të meta, parimet e kontrollit të popullsisë kanë qenë në fuqi ndoshta në të gjitha kulturat.

Por në kohën e industrializimit viktorian, me një klasë punëtore gjithnjë në zgjerim, dhe në vazhdim të evolucionit darvinian, gjysmë-kushëri i Darvinit, Frensis Galton, i dha një lustër shkencore dhe statistikore gdhendjes së

qëllimshme të shoqërisë. Ai e quajti eugjenikë këtë disiplinë. Ishte një ideologji politike, e cila iu bashkë-vendos shkencës shumë të re dhe të papjekur të evolucionit, dhe u bë një nga idetë përcaktuese dhe më vdekjeprurëse të shekullit XX-të. Britania e Madhe miratoi një ligj për sterilizimin e pavullneshëm të “të padëshiruarve”, për të cilin bëri fushatë edhe vetë Uinston Çerçilli, kur ishte pjesë e kabinetit të drejtuar nga Eskuit.

Në SHBA, politikat eugjenike nisën të miratohen që nga viti 1907, dhe gjatë pjesës më të madhe të atij shekulli në 31 shtete. Rreth 80.000 njerëz u sterilizuan nga shteti në emër të higjenës eugjenike. Eugjenika amerikane bazohej tek ligjet e Mendelit, edhe pse vetë Mendeli nuk kishte asnjë lidhje me këto politika.

E udhëhequr nga Çarls Davenport – një biolog fanatik i fiksuar pas ideve të Galtonit – Zyra e Rekordëve Eugjenike në Nju Jork, nisi në vitin 1910 promovimin e një ideologji raciste. Davenport mendonte se mund të përcaktonte trashëgiminë e tipareve të dëshirueshme duke shmangur të metat, dhe në këtë mënyrë do ta “pastronte” popullin amerikan.

Në këtë mënyrë, ai mendoi se mund t'i kundërvihej kërcënimit të imagjinuar të Teorisë së Zëvendësimit të Madh, me të cilin përballej Amerika e të bardhëve: njerëzit e padëshiruar, me pjellorinë e tyre të padisiplinuar, do të përhapin gjenet inferiore, dhe kësaj do të zhdrukun klasat sunduese.

Davenport u përpoq të shpjegonte me ligjet mendeliane të gjitha llojet e të metave të njerëzore: alkoolizmin, kriminalitetin, sëmundjet mendore. “Ligjet e trashëgimisë janë një shpresë e madhe e racës njerëzore; janë shpëtimtari i saj nga budallallëku, varfëria, sëmundja, imoraliteti” shkroi ai në vitin 1910.

Nga ajo epokë spikat një histori e veçantë. Psikologu Henri Godard kishte studiuar një vajzë me pseudonimin Deborah Kalikak në klinikën e tij në Nju Xhersi, që kur ajo ishte 8 vjeçe. Ai e përshkroi atë si një “njeri me mendje të dobët, budallaqë dhe me prirje kriminale”.

Për të zbuluar originën e të metave të saj, Godard prodhoi një pemë genealogjike të familjes Kalikak. Ai identifikoi si



themelues të kësaj linje gjaku Martin Kalikak, që gjatë rrugës për në shtëpi pas përfundimit të luftës së pavarësisë, u ndal në një bar për të lënë shtatzënë një “kamariere budallaqë, por fizikisht tërheqëse”, me të cilën ai nuk pati kontakte të mëtejshme. Në librin me ndikim vitit 1912 “Familja Kalikak: Studim mbi trashëgiminë e mendjes së dobët”, ai gjermoi një model të përsosur të trashëgimisë Mendeliane për tiparet e mira dhe të këqija.

Familja legjitime ishte shumë e suksesshme, ndërsa pasardhësit e tij bastardë krijuan një klan kriminelësh dhe njerëzish me aftësi të kufizuara, duke përfunduar tek vogëlushja Debora.

Godard arriti në përfundimin se budallallëku i familjes Kalikak ishte koduar tek një gjen, një njësi e vetme e trashëgimisë me të meta, e transmetuar brez pas brezi, ashtu si tek bizelet e Mendelit.

Një gjenetist në kohët e sotme, do të kishte rezerva për shumë arsye. E para ka të bëjë me terminologjinë “njeri mendjedobët”, e cila ishte një diagnozë e paqartë, pseudopsikiatrike, që ne supozojmë se përfshinte një gamë të gjerë të problemeve mendore që njihen sot.

Po ashtu, sot mund ta hedhim poshtë përfundimin e tij Mendelian, me arsyetimin se çrregullimet komplekse psikiatrike, kanë rrallë një rrënjë të vetme gjenetike, dhe ndikohen gjithmonë shumë nga mjedisi. Prania e një gjeni të caktuar, nuk do të përcaktojë rezultatin e një tipari, edhe pse mund të kontribuojë në

probabilitetin e shfaqjes së tij. Familja legjitime e Martin Kalikak ishte vërtetë e mbushur me njerëz të suksesshëm. Shumë burra të saj spikatën në mjekësi, jurisprudencë dhe si klerikë. Por Godard kishte shpikur degën e paligjshme, duke identifikuar gabimisht një burrë me emrin Xhon Uolverton si djalin e paligjshëm të Kalikak. Në mesin e pasardhësve të Uolverton, kishte njerëz me aftësi të kufizuara. Por fotot e botuara në librin e Godard tregojnë disa nga fëmijët, me tipare të fytyrës që lidhen me Sindromën e Fetusit Alkoolik, një gjendje që përcaktohet tërësisht jo nga trashëgimia gjenetike, por nga ekspozimi ndaj niveleve të larta të alkoolit në mitër.

Pavarësisht se pema familjare ishte krejtësisht e rreme, ky rast studimor mbeti në tekstet e psikologjisë deri në vitet 1950, si një model i trashëgimisë njerëzore, dhe si një justifikim për sterilizimin e detyruar. Lëvizja gjermane eugjenike, i pati fillesat e veta në fillim të shekullit XX-20, dhe u zhvillua shumë gjatë viteve të Republikës së Vajmarit.

Në kohën e themelimit të Rajhut të Tretë nga nazistët, parime të tilla si ‘Lebensun eertesLeben’ – jetë e padenjë për të ekzistuar – ishin një pjesë thelbësore e ideologjisë kombëtare eugjenike për pastrimin e popullit gjerman.

Një nga ligjet e para që u miratua pasi Hitleri mori pushtetin në vitin 1933 ishte Ligji për Parandalimin e Pasardhësve me Sëmundje Gjenetike, që kërkonte sterilizimin e njerëzve


me skizofreni, shurdhim, verbëri, epilepsi, Sëmundjen e Huntingtonit, apo gjendje të tjera që konsideroheshin qartësisht me prejardhje gjenetike.

Zhvillimi i programeve eugjenike nga nazistët, u mbështet intelektualisht dhe financiarisht nga eugjenistët amerikanë. Gati 400.000 njerëz u sterilizuan sipas kësaj politike. Kështu, një gënjeshtër shkencore, ishte shndërruar në bazën e një gjenocidi. Shkenca ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e politizuar.

Njerëzit i drejtohen autoritetit të shkencës për të justifikuar ideologjitë e tyre. Sot, ne shohim të njëjtin model, por me një gjenetikë të re. Pas të shtënave në një shkollë në Bufalo, SHBA, në maj, pati një diskutim të forta në komunitetin e gjenetistëve, pasi vrasësi kishte përmendur një studim akademike në manifestin e tij të çmendur, disa dokumente mbi gjenetikën e inteligjencës dhe bazën gjenetike të prejardhjes hebreje, së bashku me pseudoshkencën e vazhdueshme ku bazohet Teoria e Zëvendësimit të Madh. Shkenca përpiqet të jetë apolitike, të ngrihet mbi botët e rrëmuishme të politikës, dhe paragjykimet psikologjike me të cilat jemi të ngarkuar. Por të gjitha zbulimet e reja shkencore, ekzistojnë brenda kulturës në të cilën ato kanë lindur, dhe janë gjithmonë të ndjeshme ndaj abuzimit. Të njohësh historinë tonë, do të thotë të “vaksinohehi” kundër përsëritjes së saj. / “The Guardian” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Llapi, Prishtina dhe Gjilani e nisin me fitore



PODUJEVË, 14 GUSHT - Skuadra e Llapit e ka nisur me fitore edicionin e ri në Superligën e Kosovës në futboll. Llapjanët kanë fituar si mysafir në duel me Drenicën, me rezultat 1:0, ndeshje e cila u zhvillua në stadiumin "18 Qershori" në Klinë, pasi fusha në stadiumin "Bajram Aliu" ende nuk është e gatshme pas intervenimeve për instalimin e sistemit të ujitjes. Goli i vetëm i kësaj ndeshje u realizua në minutën e 34-t, kur gjuajtja e fortë e Kushtrim Shabanit fillimisht qëlloi shtyllën e më pas e goditi në shpinë portierin Shala dhe përfundoi në rrjetë. Në pjesën

e dytë kuqezinjtë e Skenderajt u përpoqën maksimalisht për të ndryshuar shifrat dhe për t'iu shmangur humbjes, por llapjanët arritën ta menaxhojnë mirë lojën. Ndërsa të shtunën Prishtina dhe Gjilani kanë shënuar fitore në frymën e fundit të ndeshjeve, derisa skuadra nënkampione në fuqi, Drita, ka arritur t'i shmanget humbjes në Mitrovicë, ndonëse në pjesën e parë ishte në disavantazh prej dy golash. Gjilani ka arritur të fitojë para tifozëve të vet në duel me Ferizajn, me rezultat 3:2, në një duel që ka prodhuar lojë të mirë dhe shumë gola. E këtë

ndeshje e ka ndjekur nga afër presidenti i FFK-së, Agim Ademi. Mevlan Zeka i dha epërsinë vendësve në minutën e 24-t, me golin e shënuar me kokë pas harkimit të Përparim Islamit. Shifrat i barazoi 11 minuta më pas Ramush Ramadani, derisa pas 4 minutash lojë në pjesën e dytë, Ferizaj arriti ta përmbysë rezultatit me golin e Betim Haxhimusës. Megjithatë, kjo nuk ishte përmbysja e vetme në këtë takim, pasi Gjilani nuk u dorëzua dhe arriti që me dy gola të përforcimit të ri Theophilus Solomon, në minutat 84 e 90'+3' t'i gëzohet fitores. Minuta e tretë e kohës

shtesë ishte më fat edhe për Prishtinën, e cila me golin e Muhamed Useinit iu gëzua fitores në Klinë në përballje me Dukagjinin (2:1). Paraprakisht Prishtina kaloi në epërsi në minutën e 27-të, me supergolin e Endrit Krasniqit nga gjuajtja e lirë, që njëherësh ishte goli i parë i këtij edicioni. Dukagjini i barazoi shifrat në minutën e 40-të, me golin e Ahmed Januzit. Dhe kur dukej se ndeshja do të mbyllej pa fitues, Useini arriti që në frymën e fundit të ndeshjes të realizoi me kokë. Mjaft interesante ishte edhe ndeshja në stadiumin "Riza Lushta", ku skuadra e rikthyer në elitë, Trepça'89 pati paraqitje

të shkëlqyeshme në duel me Dritën (2:2). "Minatorët" pjesën e parë e mbyllën në epërsi 2:0, ku Christian Mba shënoi dy gola të shpejtë për skuadrën e Shpëtim Idrizit, në minutat 36' dhe 38'. Megjithatë, Drita pati paraqitje më të mirë në pjesën e dytë dhe arriti t'i shmanget humbjes me golat e Drilon Islamit, në minutën e 70-të dhe Ardit Tahirit nga penalltia në minutën e 85-të. Nesër zhvillohet ndeshja ndërmjet Drenicës dhe Llapit, derisa dueli ndërmjet Malishevës dhe Ballkanit është shtyrë, ngase skuadra portokallezi luan në 'play-off' të Ligës së Konferencës.

Kosova U19, e gjashta në Kampionatin Ballkanik

PRISHTINË, 14 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës U19, femrat, ka mbyllur aventurën në Kampionatin Ballkanik që u zhvillua në Mioveni të Rumanisë, me ndeshjen për vend të pestë

kundër Bullgarisë, të dielën në mëngjes. Vashat "Dardane" u desh të pajtohen me një disfatë 0-3 (8:25, 14:25, 10:25) nga rivalet bullgare në këtë përballje, por nga ky

Kampionat Ballkanik dalin si ekipi i gjashtë më i mirë, pasi mposhtë Maqedoninë e Veriut për këtë pozitë. Kujtojmë se Kosova ishte pjesë e Grupit A në këtë kompeticion, ku bënë pjesë

Kombëtare shumë të forta si ajo e Bullgarisë, Turqisë dhe Rumanisë. Në tërësi, ishte një përvojë e mirë për këto lojtare që në të ardhmen pritet të jenë pjesë edhe e ekipit senior.





Kosova në Lojërat Evropiane të Çiklizmit, Nuha: Është arritje e jashtëzakonshme

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kosova, përkatësisht Federata e Çiklizmit do të përfaqësohet për herë të parë me dy çiklistë në një garë evropiane. Çiklistët Alban Delija dhe Blerton Nuha do të marrin pjesë në Lojërat Evropiane, që do të mbahen në Mynih të Gjermanisë, më 14 dhe 17 gusht në disiplinat ITT dhe Road Race. Kryetari i Federatës së Çiklizmit të Kosovës, Avni Nuha, në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se pjesëmarrja në këtë garë është një arritje e madhe për çiklizmin në Kosovë dhe se janë bërë të gjitha përgatitjet për një përfaqësim dinjitoz nga dy garuesit kosovarë. "Federata e Çiklizmit të Kosovës me rregulloren botërore të çiklizmit ka bërë ftesën zyrtare nga Federata Botërore dhe ajo Evropiane

që në Kampionatin Evropian, i cili do të mbahet në Mynhen, më datën 14 dhe 17 gusht, ku ne do t'i kemi dy çiklistë, Alban Deliajn dhe Blerton Nuhën, të cilët të cilët janë kampion edhe vitin e kaluar, edhe këtë vit dhe ne si federatë i kemi mbështetur me të gjitha aspektet përgatitore, logjistike dhe nesër fillojmë rrugën për në Mynhen, ku na presin më të vërtetë një garë, një sfidë e jashtëzakonshme dhe këtu është elita kryesore e çiklizmit botëror, ku ka kampion botëror, kampion olimpiq", ka thënë Nuha. I pari i Federatës së Çiklizmit thotë se pritet nga kjo garë për Kosovën nuk duhet të jenë të mëdha për shkak se aty do të marrin pjesë mbi 200 çiklistë të nivelit më të lartë evropian dhe botëror. "Të them të drejtën, të dy

klubet, njëri është nga klubi i çiklizmit "Kastrioti" dhe tjetri është nga klubi i çiklizmit "Gjakova 137". Janë duke punuar në një kohë të cilët një muaj e gjysmë ka qenë në karantinë Blertoni në Shqipëri ku është përgatitur me dy trajnerë nga Shqipëria, ashtu edhe Alban Delija ka ushtruar sipas informative që i kemi nga trajneri i tij. Mendojmë të kemi fat por në këto gara është vështirë sepse aty janë 200 çiklistë dhe secili pretendon të fitojë dhe unë vetëm uroj që më i miri të fitojë", theksoi Nuha. Sa i përket situatës në të cilën gjendet momentalisht çiklizmi si sport në Kosovë, Nuha tha se mbetet punë e madhe për t'u bërë, derisa zbuloi se së shpejti do të fillohet me aktivitete në të gjitha shkollat në Kosovë.

"Klubet në Kosovë duhet të punojnë më shumë. Shumë herë e ceku që klubet në Kosovë janë në gjendje jo të mirë stabile financiare dhe ka klube që kanë një sportistë ose dy dhe atë e mban vetëm për arsye të pasionit që e ka për çiklizmin. Përndryshe, ne jemi duke punuar si federatë që prej muajit shtator të bëjmë përgatitjet dhe aktivitetet brenda shkollave në Kosovë...dhe aty të thithim ndonjë çiklist të mirë dhe të përgatitemi për arenat ndërkombëtare. Ne jemi duke punuar për një vizion më të gjatë për çiklistët, nuk jemi duke punuar që vetëm të marrim pjesë në këtë kampionat dhe të përfundon çdo gjë. Ne pret punë e madhe, na presin sfida të jashtëzakonshme si

federatë", ka shtuar Nuha. Sa i përket infrastrukturës që i nevojitet këtij sporti, Nuha ka treguar e në Kosovë janë krijuar shtigje të niveleve shumë të larta që e mundësojnë ushtrimin e sportit të çiklizmit. "Unë kam qenë në shumë vende të botës që merren me çiklizëm. Kosova ka bërë shtigje të jashtëzakonshme për përgatitje të çiklistëve të Kosovës. Nevojitet vetëm një përkushtim. Infrastruktura është në nivelin më të lartë dhe unë gjithmonë i falënderoj Policinë e Kosovës të cilët me të vërtetë kur bëjmë aktivitete na mbështesin jashtëzakonisht dhe e ardhmja e çiklizmit në Kosovë është 100 për qind e sigurt, vetëm duhet të punohet më shumë me përkushtim", ka përfunduar Nuha.

Debi i Londrës përfundoi pa fitues

Londër, 14 gusht - Chelsea ka barazuar 2-2 me Tottenham në derbin e Londrës, të vlefshëm për Premier Ligë. Pjesa e parë do përfundonte

1-0 në favor të djemve të Tuchel. Koulibaly do lëshonte një goditje të bukur në minutën e 19-të, duke çuar topin pas shpinës së

Lloris. Barazimi do vinte në minutën e 68-të nga Hojbjerg. Chelsea do rimerrte epërsinë në minutën e 77-të me James,

me rezultatin që do ndryshonte në fund, nga një gol i Kane. Në minutat shtesë u aktivizua edhe Armando Broja.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref. AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS
PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR

I. Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave një (1) pozitë, për dy (2) vite

Referenca:	KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ- 013
Emri pozitës:	Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
Pozita:	Pozitë jo e karrierës
Niveli:	Drejtues
Kodi punës:	DR/1070
Raporton tek:	Kryeprokurori i Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Pesëmbëdhjete (15)
Akti i emërimit:	Me afat te caktuar
Vendi :	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, mbikëqyrja, koordinimi dhe menaxhimi i punës së gjithmbarshme të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, duke përcaktuar politikën, standardet dhe veprimet në përputhje me legjislacionin përkatës. Harton programe, projekte, strategji dhe kujdeset për implementimin e tyre në mënyrë aktive, menaxhon me mjetet buxhetore dhe donacionet e ndryshme të siguruar për ZMNV. Koordinon punën në nivel të institucionit të prokurorit të shtetit dhe me partnerët e jashtëm dhe ndërkombëtar.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Menaxhon me punën e gjithmbarshme të zyrës së ZMNV-ës dhe personelin e sajë, përfaqëson zyrën brenda institucionit të PSH dhe para institucioneve tjera në vend dhe jashtë vendit;

Koordinon punën me vartësit e vet lidhur me zbatimin e objektivave të punës, mbështetur në strategjinë, planet dhe ligjin;

Kujdeset për hartimin dhe implementimin e politikave për ZMNV, duke i harmonizuar procedurat e brendshme në përputhje me ligjet e aplikueshme;

Përgjegjës për sigurimin e hapësirave dhe kushteve për punë të punësuarve në bashkëpunim me strukturën organizative dhe zyrat e institucionit të PSH-së;

Merr pjesë në organizimin e programeve të ndryshme që kanë të bëjnë me mandatin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;

Këshillon stafin e ZMNV-ës, lidhur me zbatimin e procedurave dhe projekteve që kanë të bëjnë me Zyrtarët për Mbrojtje të Viktimave;

Raporton në periudha të përcaktuara në nivel të institucionit të PSH-ës, mbi punën dhe të arriturat e ZMNV-ës;

Ndërmerr të gjitha veprimet ligjore ndaj personelit të ZMNV-ës, në të gjitha nivelet për zbatimin e politikave dhe përgjegjësi të secilit të punësuar dhe është përgjegjës për të njëjtit.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Aftësi të larta komunikuese, negociemeve dhe bindëse në menaxhim;

Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës së Zyrës për zgjidhjen e problemeve profesionale dhe organizative të rëndësishme për institucionin;

Njohuri të thella dhe të specializuara për kryerje e punëve të MV;

Njohuri të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj);

Shkathtësi komunikuese me sjellje korrekte të besueshme dhe konfidenciale;

Shkathtësi për hartim të akteve dhe shkresave dhe komunikim;

Shkathtësi për të caktuar prioritetet e shqyrtimit të rasteve që ndërliiden me punën e MV.;

Të jetë i trajnuar në fushën e MV;

Gatishmëri të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;

Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me te;

Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion;

Aftësi të përgjithshme për raportim të rezultateve të arritura të punës si MV, Reagimi duhur në zgjidhjen e problemeve.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare

Përvoja e Punës:

Së paku shtatë (7) vite përvojë pune

Duke përfshirë katër (4) vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

II. Zyrtar për Buxhet dhe Financa

Prokuroria Themelore Prizren, një (1) pozitë, për nëntë (9) muaj

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 014
Emri pozitës:	Zyrtar për Buxhet dhe Financa
Pozita:	Pozitë jo e karrierës

Niveli:	Profesional
Kodi punës:	BF/210
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Me afat te caktuar
Puna Provuese:	Tre (3) muaj
Vendi :	Prizren

Qëllimi i vendit të punës:

Zyrtari Financiar brenda njësisë organizative planifikon nevojat buxhetore, kontrollon rregullsinë e faturave, përditëson të dhënat në sistemin e pagesave për avokatë dhe ekspertë, mban evidencën e faturave si dhe sigurohet që dorëzimi i faturave të bëhet brenda afateve ligjore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Në konsultim me administratorin dhe kryeprokurorin përgatit nevojat për rishikim të buxhetit, nevojat buxhetore për vitin e ardhshëm dhe planifikimet e hershme për 2 vitet në vijim.

Sigurohet që faturat brenda njësisë organizative janë të rregullta, të sakta, dhe të plota dhe mban evidencën e faturave dhe sigurohet që të mos ketë përsëritje të faturave dhe te jene brenda afateve ligjore.

Regjistron dhe përditëson sistemin e pagesave për avokatë dhe ekspertë.

Sigurohet që kërkesat për para të imta (petty cash) të jenë bazuar në ligj dhe përgatit kërkesat respektive.

Përgatitja e kërkesave për mëditje dhe avance për të gjithë personelin e njësisë organizative.

Përgatit urdhër blerjet, kërkesat për zotime dhe shlyerje të obligimeve për të gjitha faturat e njësisë organizative si dhe sigurohet që të gjitha të jenë të nënshkruara nga zyrtarët autorizues.

Harton raporte të rregullta dhe ad hoc për gjendjen e faturave në njësinë organizative dhe njësinë qendrore

organizative dhe raporton në baza të rregullta për obligimet e faturave të papaguara në njësinë qendrore organizative.

Përgatit plan të punës në përputhje me ligjin, rregulloret, politikën dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara.

Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor Financiar dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera profesionale nga lëmin e financave publike;

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale lidhur me financat;

Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Access, Power Point) dhe internetin;

Shkathtësi të punojë në mjedis shumetnik dhe për punë ekipore;

Shkathtësi për të caktuar synimet më të rëndësishme dhe dhënia e prioriteteve atyre;

Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;

Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik

Përvoja e Punës:

Dy (2) vjet përvojë pune.

- Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **15.08.2022 deri me datë 22.08.2022** si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
 - Dy rekomandime (nëse keni);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
 - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i člana 18 Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi Kosova, na osnovu Presude br. Ref AGJ.1583/20 od 9 jula 2020 godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje:

**K O N K U R S
ZA ZAPOSŁJAVANJE NA ODREĐENO VREME**

I. Rukovodilac Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Źrtvama

Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Źrtvama jedna (1) pozicija, za dve (2) godine

Referenca: KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ- 013
Naziv radnog mesta: Rukovodilac Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Źrtvama
Pozicija: pozicija Pozicija ne karijere
Nivo: Rukovodeći
Šifra posla: DR/1070
Izveštava: Glavnom Državnom Tužiocu, Generalnom Direktor Sekretarijata TSK
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficienat: Petnaest (15)
Akt o imenovanju: Na određeno vreme
Mesto: Priština

Namena radnog mesta:

Rukovođenje, nadzor, koordinacija i upravljanje celokupnog rada Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Źrtvama, definirajući politike, standarde delovanja u skladu sa relevantnim zakonodavstvom. Oznaci programe, projekte, strategije i aktivno se brine o njihovoj implementaciji, upravlja budžetskim sredstvima i raznim donacijama predviđenim za KZPŹ. Koordinira rad na nivou institucije Državnog Tužioca i sa spoljnim i međunarodnim partnerima.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Rukovodi celokupnim radom kancelarije KZPŹ-a i njenog osoblja, zastuplja kancelariju u okviru ustanove DT i pred ostalim institucijama u zemlji i inostranstvu;
Koordinira rad sa podređenima na realizaciji radnih ciljeva, na osnovu strategije, planova i zakona;
Pobrine se o izradi i sprovođenju politika za KZPŹ, usklađivajući unutrašnje procedure u skladu sa važećim zakonima;
Odgovoran za obezbeđivanje prostora i uslova za rad zaposlenih u saradnji sa organizacionom strukturom i kancelarijama DT ustanove;
Učestvuje u organizaciji različitih programa u vezi sa mandatom Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Źrtvama;
Savetuje osoblje KZPŹ-a u vezi sa sprovođenjem procedura i projekata u vezi sa Službenicima za Zaštitu Źrtava;
Izveštava u periodima određenim na nivou ustanove DT o radu i dostignućima KZPŹ;
Preduzima sve pravne radnje protiv osoblja KZPŹ-a, na svim nivoima za sprovođenje politike i odgovornosti svakog zaposlenog i za iste je odgovoran.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Visoke veštine komunikacije, pregovaranja i ubeđivanja u menadžmentu;
Fleksibilan pristup organizaciji i nadzoru rada Kancelarije za rešavanje stručnih i organizacionih problema od značaja za ustanovu;
Detaljna i specijalizovana znanja za izvršenje poslova ZŹ;
Dobro poznavanje rada na kompjuteru sa apliciranjem programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.);
Veštine komunikacije sa ispravnim pouzdanim i poverljivim ponašanjem;
Veštine za izradu akata i dokumenata i komunikaciju;
Sposobnost određivanja prioriteta za razmatranje predmeta u vezi sa radom ZŹ;
Da ima obuke iz oblasti ZŹ;
Spremnost za rad sa ljudima različitih nacionalnosti i veroispovesti;
Sposobnost preduzimanja konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi sa njim;
Sposobnost održavanja kvaliteta rada iu uslovima rada pod pritiskom ;
Opšte veštine za izveštavanje o postignutim rezultatima rada kao ZŹ, Odgovarajuće reagovanje u rešavanju problema.

Stručna sprema i kvalifikacija :

Univerzitetska Diploma

Radno iskustvo:

Najmanje sedam (7) godina radnog iskustva.

Uključujući četiri (4) godine radnog iskustva na rukovodećim pozicijama

II. Službenik za Budžet i Finansije

Osnovno Tužilaštvo u Prizrenu, jedna (1) pozicija, za devet (9) meseci

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 014
Naziv radnog mesta: Službenik za Budžet i Finansije

Pozicija: pozicija Pozicija ne karijere
Nivo: Profesionalni
Šifra posla: BF/210
Izveštava: Administratoru Tužilaštva
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficienat: Sedam (7)
Akt o imenovanju: Na određeno vreme
Probni rad: Tri (3) meseca
Mesto: Prizren

Svrha radnog mesta:

Finansijski službenik u okviru organizacione jedinice planira budžetske potrebe, proverava ispravnost računa, ažurira podatke u platnom sistemu za advokate i stručnjake, vodi evidenciju računa i osigurava da se predaja računa vrši u zakonskim rokovima.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

U konsultaciji sa administratorom i glavnim tužiocem priprema potrebe za pregledom budžeta, budžetske potrebe za sledeću godinu i rano planiranje za naredne 2 godine. Osigurava da su računi u organizacionoj jedinici redovni, tačni i potpuni i da prati račune i osigurava da ne dolazi do dupliranja računa i da su u zakonskim rokovima. Registruje i ažurira sistem plaćanja za advokate i stručnjake.

Osigurava da se potraživanja za sitni novac (petty cash) zasnivaju na zakonu i priprema odgovarajuća potraživanja.

Priprema dnevnicu i avansnih zahteva za celo osoblje organizacione jedinice.

Priprema naloge za kupovinu, zahteve za preuzimanje obaveza i izmirivanje obaveza za sve račune organizacione jedinice i osigurava da su svi potpisani od strane službenika za odobravanje.

Sastavlja redovne i ad hoc izveštaje o statusu računa u organizacionoj jedinici i centralnoj organizacionoj jedinici i redovno izveštava o neizmirenim obavezama po fakturi u centralnoj organizacionoj jedinici.

Priprema plan rada u skladu sa zakonom, propisima, politikama i procedurama, unutar određenih rokovima.

Oblavlja sve druge dužnosti u skladu sa važećim zakonom koji se mogu povremeno zatražiti na razuman način od strane glavnog finansijskog direktora i direktnog nadzornika;

Znanje, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Odlično profesionalno znanje u oblasti javnih finansija;

Odlično i sveobuhvatno profesionalno znanje vezano za finansije;

Dobro poznavanje računarskih veština i primenjivanje aplikacija (Microsoft Word, Excel, Access, Power Point) i interneta;

Veštine za rad u multietničkom okruženju i za timski rad;

Sposobnost postavljanja najvažnijih ciljeva i davanja prioriteta istima;

Sposobnost preduzimanja konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi sa istim;

Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i u radnim uslovima pod pritiskom;

Profesionalna sprema i kvalifikacije:

Univerzitetska Diploma, Ekonomski Fakultet

Radno iskustvo:

Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 15.08.2022 do 22.08.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:
 - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
 - "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmjenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Udhëheqës i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend

Departamenti: Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare

Divizioni: Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend

Niveli i gradës: 4

I raporton: Drejtorit të Departamentit për Mbikëqyrje Bankare

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përcakton fushëveprimin dhe mbikëqyrjen e ekzaminimeve në vend në banka;
- Merr pjesë dhe kryen ekzaminimet në vend të bankave;
- Merr pjesë në takime dhe komunikon konkluzionet e ekzaminimit të bankave;
- Shqyrton dhe vlerëson raportet e ekzaminimit të përgatitura nga ekzaminierët përgjegjës për banka dhe vartësit tjerë për fushat e tyre të përgjegjësisë në ekzaminimet në vend në banka;
- Përgatitë strategjitë mbikëqyrëse konform profilit të rrezikut të bankave dhe rekomandon shpeshësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve të fokusuar në vend;
- Përpilon rekomandimet për adresimin e gjetjeve të evidentuara në banka;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve, kërkesave nga ekzaminimet në vend, masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave;
- Bashkëpunon me divizionin e raportimit dhe analizave si dhe divizionin e mbikëqyrjes së IMF-ve dhe IFJB-ve në funksion të kryerjes së punës;
- Përpilon planet individuale zhvillimore për vartësit;
- Propozon planin vjetor për ekzaminimet në vend të bankave;
- Propozon buxhetin dhe trajnimet e stafit në bazë të nevojave të zhvillimit profesional si dhe kryen vlerësimet e performancës së stafit;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë vartësve;
- Përpilon raportet periodike dhe të tjera të divizionit të mbikëqyrjes në vend të bankave;
- Propozon politikat mbikëqyrëse, rregulloret, manualet dhe procedurat tjera të punës;
- Detyra tjera të përcaktuara nga mbikëqyrësi.

Edukimi:

- Të posedoj diplomë nga fusha e ekonomisë, financave, kontabilitetit ose të ngjashme, ndërsa studimet pasuniversitare paraqesin përparësi;
- Njohuri e mirë e kornizës së Bazelit dhe standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes së bankave paraqesin përparësi.

Përvoja e punës:

- Të ketë minimum përvojë pune në sektor bankar, së paku pesë (5) vite;
- Përvoja menaxheriale paraqet përparësi.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohuri e gjuhës angleze.

Njohuritë e kërkuara:

- Të posedon njohuri të mira të kontabilitetit, standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe çështjeve rregullative;
- Preferohet të ketë diplomë/certifikatë ekuivalente i nivelit të kontabilitetit të certifikuar dhe/ose të auditorit të certifikuar;
- Njohje e shkëlqyeshme e MS. Office;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomatat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 gusht 2022**
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OPIS RADNOG MESTA

Naslov: Rukovodilac Odseka za nadzor na licu mesta

Odeljenje/odsek: Odeljenje za bankarski nadzor

Stepen: Četiri (4)

Izveštava: Direktor Odeljenja za bankarski nadzor

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Utvrđuje delokrug i nadzor nad inspekcijama na licu mesta u bankama;
- Učestvuje i vrši inspekcije na licu mesta u bankama;
- Učestvuje na sastancima i saopštava zaključke o inspekcijama banaka;
- Razmatra i procenjuje izveštaje o inspekcijama koje su pripremili nadležni inspektori za banke i ostali podređeni za njihove oblasti nadležnosti u inspekcijama na licu mesta u bankama;
- Priprema nadzorne strategije u skladu sa profilom rizika banaka i preporučuje učestalost i delokrug inspekcija fokusiranih na licu mesta;
- Sastavlja preporuke za rešavanje zabeleženih nalaza u bankama;
- Prati sprovođenje preporuka, zahteva od inspekcija na licu mesta, prinudnih mera izrečenih protiv banaka;
- Saraduje sa Odsekom za izveštavanje i analize kao i Odsekom za nadzor nad MFI i NBFi u funkciji obavljanja posla;
- Sastavlja individualne razvojne planove za podređene;
- Predlaže godišnji plan za inspekcije na licu mesta banaka;
- Predlaže budžet i obuke osoblja na osnovu potreba za stručnim razvojem, kao i obavlja procene učinka osoblja;
- Daje uputstva i prenosi znanja podređenima;
- Sastavlja periodične i druge izveštaje Odseka za nadzor na licu mesta banaka;
- Predlaže nadzorne politike, uredbes, priručnike i druge procedure rada;
- Ostale dužnosti koje mu odredi nadzornik.

Obrazovanje:

- Da poseduje diplomu iz oblasti ekonomije, finansija, računovodstva ili slično, dok postdiplomske studije predstavljaju prednost;
- Dobro poznavanje Bazelskog okvira i međunarodnih standarda nadzora nad bankama predstavljaju prednost.

Radno iskustvo:

- Da poseduje radno iskustvo u bankarskom sektoru u trajanju od najmanje pet (5) godina;
- Menadžersko iskustvo predstavlja prednost.

Poznavanje jezika:

- Odlično poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika.

Potrebna znanja:

- Da poseduje dobra znanja za računovodstvo, međunarodne standarde finansijskog izveštavanja, kao i regulatornih pitanja;
- Poželjno je posedovanje diplome/sertifikata ekvivalentnog nivou sertifikovanog računovođe i/ili sertifikovanog revizora;
- Odlično poznavanje Ms. Office;

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za aplikaciju;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj iz Penzionog fonda koji dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **29. augusta 2022. godine.**
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**